

Departamenti i Demokratizimit
Sektori për pjesëmarrje publike

Prishtinë/Priština, 04/04/2017

**Ftesë e hapur
për
Njëzet (20) kandidatë për program tremujor të punës praktike**

**Projekti: Avancimi i rolit të OSHC-ve, grave dhe burrave të rinj lider të së
ardhmes në vendimmarrje dhe jetë publike**

**3.2 Mbështetja e liderëve të rinj të së ardhmes përmes programit të OSBE-
së për punë praktike**

Sfondi

Pjesëmarrja publike e të rinjve në vendimmarrje garantohet dhe promovohet nëpërmjet një kuadri relativisht të hollësishëm dhe gjithëpërfshirës normativ dhe të politikave që rregullon fuqizimin dhe pjesëmarrjen e të rinjve në Kosovë. Ky kuadër përfshin Ligjin për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë, katër udhëzime administrative (UA), si dhe Strategjinë për rininë që përcakton prioritetet dhe synimet për periudhën 2013-2017 dhe Planin e rishikuar të veprimit për periudhën 2016-2017.

Të rinjtë kanë të drejta dhe mundësi për të ndikuar në vendimmarrje dhe politikëbërje, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë, qoftë nëpërmjet organeve përfaqësuese ekzistuese dhe organizatave të shoqërisë civile.

Megjithatë, të rinjtë e kanë shpeshherë të pamundur që t'i realizojnë të drejtat dhe përmbushin përgjegjësitë në lidhje me përfshirjen në vendimmarrje, kjo për dy arsye: nga njëra anë, të rinjtë mund të mos i kenë vetëdijen, kapacitetet, njohuritë, shkathtësitë teknike dhe përvojën e nevojshme, ndërsa, nga ana tjetër, institucionet në nivel qendror dhe lokal ofrojnë pak mundësi për përfshirjen e rinjve në vendimmarrje dhe politikëbërje. Si rrjedhojë, të rinjtë shkurajohen ose ndihen të lënë jashtë nga pjesëmarrja në vendimmarrje dhe politikëbërje dhe bëhen të izoluar.

OSBE promovon angazhimin e të rinjve në proceset e vendimmarrjes dhe politikëbërjes përmes qasjes së pjesëmarrjes aktive, që bazohet në parimin e të mësuarit nga përvoja dhe si qëllim ka t'i pajisë të rinjtë me shkathtësi dhe njohuri adekuate të transferueshme. OSBE do të mbështesë organizimin e një programi tremujor të punës praktike profesionale për 20 të rinj të moshës 20-24 vjeç, në bashkëpunim me ministri të ndryshme dhe institucioneve të pavarura¹. Qëllimi i programit është që të rinjtë të angazhohen drejtpërdrejt në nivel strategjik planifikues dhe ekzekutiv të punës në institucionet kryesore vendimmarrëse dhe politikëbërëse dhe të njoftohen për së afërmi me mandatin, fushëveprimin, detyra dhe përgjegjësitë e këtyre të fundit.

¹ Siç janë: Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, si dhe Ministria e Drejtësisë; Ministria e Administratës Publike; Zyra e Komisionarit për Gjuhë dhe Institucioni i Avokatit të Popullit, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në vitin 2016.

Praktikantët do të vendosen nëpër zyra/divizione/departamente të ndryshme në kuadër të institucioneve bashkëpunuese ku do të zhvillohet puna praktike, varësisht nga profili dhe interesimet e praktikantëve, por edhe në përputhje me nevojat dhe kapacitetin e institucioneve bashkëpunuese për akomodim të praktikantëve. Mentorë të praktikantëve do të jenë zyrtarët nga zyrat/divizionet/departamentet në kuadër të institucioneve bashkëpunuese, ndërsa bashkërendimin do ta bëjë ekipi i projektit nga Sektori i OSBE-së për pjesëmarrje publike (SPP). Paraprakisht do të mbahen disa seanca të hollësishtme trajnimi, që do të organizohen bashkërisht nga ekipi i projektit i OSBE-së dhe zyrtarët e institucioneve bashkëpunuese dhe që do të jenë të përqendruara, por jo vetëm, në kuadrin ligjor, procesin e konsultimit gjatë hartimit të akteve ligjore dhe nënligjore, proceset e rishikimit, monitorimit dhe informimit, planifikimit dhe programimit, vlerësimit, hulumtimit dhe hartimit të dokumenteve të politikave etj. Gjithashtu, nga mesi i tetorit të vitit 2017 parashihet të mbahet edhe një trajnim në mes të programit.

Programi i punës praktike do të përmbyllet me një konferencë, ku praktikantët do të kenë rastin të paraqesin njohuritë e fituara dhe kontributin e dhënë në institucionet përkatëse ku kanë kryer punë praktike.

Qëllimi

OSBE ka si qëllim që përmes një programi tremujor të punës praktike në institucione të nivelit qendror t'ju ndihmojë njëzet (20) të rinjve që të mësojnë më shumë dhe të fitojnë përvojë rreth vendimmarrjes dhe politikëbërjes.

Detyrat

Varësisht nga natyra dhe plani i punës së institucioneve bashkëpunuese ku do të caktohen për ta kryer praktikën, praktikantët do të kryejnë detyrat vijuese:

- Ndihmojnë në procesin e hartimit të akteve ligjore dhe nënligjore;
- Ndihmojnë departamentin/divizionin/sektorin në ushtrimin e rolit këshillëdhënës dhe në dhënien e opinioneve që ua kanë kërkuar institucionet;
- Mbështesin departamentin/divizionin/sektorin në përgatitjen e kontributeve për raporte të jashtme;
- Kontribuojnë në zbatimin e projektit(-eve) me të cilat udhëheqin ose në të cilat kontribuon departamentin/divizionin/sektorin (planifikim/hartim/zbatim dhe/ose vlerësim);
- Ndihmojnë në bashkërendimin dhe bashkëpunimin me donatorët dhe partnerët aktualë dhe potencial;
- Kontribuojnë në proceset e planifikimit, monitorimit dhe vlerësimit të rregullt të brendshëm;
- Japin informata kthyesë lidhur me propozimet për politika përmes koncept-dokumenteve dhe pjesëmarrjes në mbledhjet përkatëse;
- Përgatisin materiale mbështetëse për mbledhjet brenda dhe jashtë institucionit, merr pjesë në to dhe mban procesverbalet;
- Kryejnë hulumtime dhe analiza nga zyra lidhur me programet e departamentit/divizionit/sektorit;
- Përpilojnë dhe propozon orar të komunikimit të rregullt me mbikëqyrësin/koordinatorin e programit;
- Kryejnë detyra të tjera sipas kërkesës së mbikëqyrësit/koordinatorit të programit.

Rezultatet e pritshme

Çdo praktikant duhet të paraqesë sa vijon:

- Raport individual mbi përvojën e përgjithshme gjatë pjesëmarrjes në programin e punës praktike në bazë të një formulari.² Raporti në fjalë duhet të vë në dukje njohuritë dhe përshtypjen që ka fituar praktikanti sa i përket vendimmarrjes dhe politikëbërjes, bazuar në përvojën praktike të tij/saj gjatë vijimit të programit;
- Plan të punës me një përshkrim të hollësishëm të detyrave dhe përgjegjësi (në bashkëpunim me mbikëqyrësin/koordinatorin e programit);
- Projektligjet, rregulloret, udhëzimet administrative në përgatitjen e të cilave ka kontribuar;
- Koncept-dokumentet dhe ato të politikave, si dhe raportet që i ka përgatitur ose në të cilat ka kontribuar;
- Analizat dhe hulumtimet, procesverbalet që i ka përpiluar;
- Numri i mbledhjeve në të cilat ka marrë pjesë, si dhe numri dhe lloji i aktiviteteve në të cilat është angazhuar.

Treguesit për matjen e performancës³

- Praktikanti i përmbahet planit 14-ditor të punës për secilin muaj;
- Praktikanti respekton orarin e punës;
- Në përfundim të programit, praktikanti është në gjendje të punojë në pajtim me dokumentet strategjike dhe planet e veprimit të institucioneve në nivel qendror;
- Në fund të programit, praktikanti i ka të qarta proceset dhe mekanizmat e vendimmarrjes dhe politikëbërjes në institucionet e nivelit qendror;
- Praktikanti tregon interesim dhe përkushtim gjatë tërë procesit të mësimnxënies.

Vendi:

Kandidatët e përzgjedhur do të caktohen për ta kryer praktikën në objektet e institucioneve bashkëpunuese në Prishtinë/Priština.

Kohëzgjatja:

Programi i punës praktike do të zgjasë tre (3) muaj (shtator- tetor-nëntor 2017).

Kandidatët e përzgjedhur do të duhet të paraqiten për punë në institucionet ku janë caktuar katërmëdhjetë (14) ditë pune në muaj për deri në gjashtë (6) orë punë në ditë.⁴

Para fillimit të praktikës në institucionet përkatëse, kandidatët e përzgjedhur do të duhet të marrin pjesë në një trajnim hyrës/përgatitor dyditor (pjesa e tretë e muajit gusht të vitit 2017). Ata gjithashtu duhet të jenë në dispozicion për një seancë njëditore trajnimi të programit kah mesi i muajit tetor i vitit 2017.

Pas përfundimit të programit, kandidatët e përzgjedhur do të duhet të marrin pjesë në një konferencë (dhjetor 2017) ku do të ndajnë me publikun përvojën dhe përshtypjet e tyre lidhur me programin e praktikës.

Kriteret për konkurrim:

² Përpilimi i raporteve individuale të praktikantëve, duke përfshirë gjetjet dhe rekomandimet, do të paraqiten nga ekipi i projektit i OSBE-së gjatë konferencës përmbyllëse të programit.

³ Mbikëqyrësi/koordinatori i çdo institucioni bashkëpunues do të përgatis një vlerësim të hollësishëm për secilin praktikantë në bazë të formularit.

⁴ Kjo do rregullohet më vonë me koordinatoret e programit në çdo institucion bashkëpunues.

- Të jetë i/e moshës 20-24 vjeçare në kohën e aplikimit në program;
- Të jetë student(e) e universitetit në kohën e aplikimit në program;
- Të jetë i/e regjistruar në një fakultet në lëmet sociologji, administratë publike, shkenca politike, juridik, marrëdhënie ndërkombëtare, menaxhim dhe administrim i biznesit etj.
- Të tregojë interesim të sigurtë në pjesëmarrjen publike të të rinjve në vendimmarrje;
- Anëtarësia në struktura rinore (Këshilli Qendror/Lokal për Veprim Rinor, Qendër Rinore) ose organizata rinore të shoqërisë civile, ose përvoja si vullnetar apo aktivist rinor është e dëshirueshme (e vërtetuar më dëshmi të anëtarësisë);
- Të ketë njohuri themelore rreth mekanizmave të pjesëmarrjes publike në nivel qendror dhe atë komunal;
- Të tregojë entuziazëm, shkathtësi të punës në grupe, motivim për punë, gatishmëri për të mësuar;
- Të ketë dëshirë për t'i avancuar shkathtësitë dhe njohuritë përmes pjesëmarrjes në këtë program;
- Të jetë i/e hapur dhe të tregojë interesim për të vendosur synime, për t'i përmbushur pritjet dhe për t'iu përshtatur sfidave të programit;
- Njohuri shumë të mirë të gjuhës angleze në të shkruar dhe në të folur; njohuri të shkëlqyer në të shkruar dhe në të folur të gjuhës shqipe, serbe ose të dyja;
- Njohuri të përdorimit të kompjuterit (programet e Microsoft-it)

Shënim: Përparësi do t'u jepet kandidatëve nga komunitetet joshqiptare, të rinjve nga zonat rurale dhe kandidateve femra.

Pagesa e propozuar:

- Secilit kandidat do t'i paguhet shuma prej 70.00 Euro në muaj për mbulimin e shpenzimeve themelore të transportit dhe ushqimit. Shuma do t'i jepet secilit pjesëmarrës në para të gatshme në fund të çdo muaji, pas dorëzimit të regjistrimit të nënshkruar për pjesëmarrje.
- Ushqimin, pijet dhe pajisjet për mbajtje të shënimeve gjatë trajnimit përgatitor, trajnimit të mesëm të programit dhe konferencës përmbyllëse do t'i sigurojë OSBE.

Shënim: OSBE nuk do të mbulojë asnjë lloj shpenzimi tjetër që mund ta kenë praktikantët.

OSBE nuk është në pozitën që të mbulojë çfarëdolloj shpenzimesh për trajtim shëndetësor apo sigurim social.

Mënyra e rekrutimit:

Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë CV-në (maksimum 1 faqe) dhe një letër motivimi (maksimum 1 faqe) në gjuhën angleze: omikapprenticeship2017@osce.org, më së largu deri më 30 qershor 2017.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do t'i nënshtrohen një procesi konkurrues të përzgjedhjes (shqyrtimi i CV-ve dhe letrave të motivimit që do të pasohet nga intervistimi).

Përzgjedhjen do ta bëjë paneli në përbërje të pjesëtarëve të institucioneve bashkëpunuese dhe ekipit të projektit të OSBE-së.